



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE	
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org.	5
Org. Jedinica	
Org. Unit	
Nr. i faqeve	2
Br. stranica	
No. pages	
Nr. Prot.	1474
Prot. No.	
Data	28.06.22
Datumi	
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 28-06-2022
Nr. 5-1474

Komisioni për licencimin e BPrAL / Kolegjeve Private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit Administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesës nr 1248 të datës 03.06.2022 të parashtruar nga BPrAL-Kolegji “ AAB ” dhe nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - Kolegji “ AAB ”, për periudhën pesë vjeçare me qendrën në Prishtinë dhe degët Ferizaj dhe Gjakovë, sipas vendimit nr. 649/22, datë 16.05.22, dhe vendimeve nr. 678/22, 679/22, të datës 26.05.2022.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 1248 i datës 03.06.2022 të parashtruar nga Kolegji “AAB”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriterët ligjore për licencim.

Licenca e këtij Institucioni Privat të Arsimit të Lartë zgjatë pesë vite akademike (1 tetor 2022 deri me 30 shtator 2027) sipas vendimit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim.

Komisioni për Licencim i MASHTI duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Sekretari i Përgjithshëm i MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. Komisionit për licencim,
3. Sekretarit të Përgjithshëm,
4. DALShT,
5. Inspektoratit të Arsimit,
6. Arkivit

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

